# AFATET NË GJYKIMIN ADMINISTRATIV

## VLERËSIMI TEMATIK KOMBËTAR 2016



INFOÇIP
Qendra për Çështjet e Informimit Publik

NED
National Endowment for Democracy
*Supporting freedom around the world*

# VLERËSIMI I AFATEVE LIGJORE NË SHQYRTIMIN GJYQESOR ADMINISTRATIV DHE DOREZIMIN E VENDIMEVE

## VITI 2016

**MONITORIMI TEMATIK KOMBËTAR**

*Botim nga*
**Qendra për Çështje të Informimit Publik**
**INFOÇIP**

Tiranë, Nentor 2017

Rr "Todi Shkurti", P. 4, H. 21 Ap.34, Tiranë ALBANIA E-mail: qendra@infocipl.org website: www.inforcip.org

**Botim nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP**
© copyright: Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP,
Nëntor, 2017

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mundet të citohet me kusht që të njihet autorësia e tij përmes referimit të plotë të atributeve
(INFOCIP, data e botimit, autorët, dhe me reference në fund të faqes edhe ISBN, etj) .
Një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur/referuar duhet t'i dërgohet INFOÇIP.
Çdo përdorim i metodës, i të dhënave teorike apo gjetjeve sasiore dhe cilesore në këtë studim, për qëllime komerciale ose jo-komerciale nga të tretë është i ndaluar dhe përbën shkak për ndjekje/penalizim ligjor.

**Drejtor i research-it & autor i metodës:**
Gerti Shella

**Konsulentë:**

Envald Seknaj
Endrit Shabani

**Koordinator kombëtar Hedhje /Analizë të dhënash:**

Donaltina Vila

**Foto:**
Fatjon Hoxha

**Layout**
Altin Aliaj

*Imazhi në Korpertinë:* **Në pritje të drejtësisë**

Botuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik

**U realizua në kuadër të projektit:**
**"Vonesat në arsyetimin dhe shpalljen e vendimeve gjyqesore-2"**

**Ky projekt është mbështetur nga National Endoëment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C. USA**
**Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të NED.**

# PERMBATJA

**KAPITULLI 1** - ***OBJEKTI, LEGJITIMITETI*** 7

MBI OBJEKTIVAT E STUDIMIT 9

BAZA LIGJORE PËR ARSYETIMIN DHE DORËZIMIN E VENDIMEVE 15

**KAPITULLI 2** - ***GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK KOMBETARE*** 21

GJETJET E MONITORIMIT 2016, GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT 23

SHKURT MBI GJYKATAT ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE 33

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, TIRANË 35

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, SHKODËR 41

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, GJIROKASTËR 47

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, KORÇË 53

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, VLORË 59

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, DURRËS 65

**KAPITULLI 3** - ***ANALIZA KRAHASUESE 2016-2015*** 73

GJYKATAT ADMINISTRATIVE TE RRETHEVE 75

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE 89

METODOLOGJIA 95

# LISTA E SHKURTIMEVE

**LGJA** – Ligji Per Gjykatat Administrative (shkurtimisht)
**GJEDNJ** – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
**KiE** – Këshilli i Europës
**GJK** – Gjykata Kushtetuese
**GJL** – Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë
**GJAA** – Gjykata Administrative e Apelit
**GJASHP** – Gjykata Administrative e Shkallës së Parë
**VGJK** – Vendim i Gjykatës Kushtetuese
**VUGJL** – Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë
**VKB** – Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
**KM** – Këshilli i Ministrave
**VKM** – Vendim i Këshillit të Ministrave
**MD** – Ministria e Drejtësisë
**KAGJL** – Kolegji Administrativ në Gjykatën e Lartë
**QBZ** – Qendra e Botimeve Zyrtare
**KPrC** – Kodi i Procedurës Civile (në disa raste: **KPC**)
**KPrP** – Kodi i Procedurës Penale (në disa raste: **KPP**)
**RSH** – Republika e Shqipërisë
**INFOÇIP** – Qendra për Çështje të Informimit Publik

# FALENDERIME

*Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP falenderon kryetarin e Gjykatës së Lartë të RSH, Z. Xhezair Zaganjori, i cili mirëpriti kërkesën e INFOÇIP për të disponuar të dhëna nga regjistrat e kësaj gjykate duke demostruar nje sens të lartë bashkëpunimi dhe transparence.*

*INFOCIP falenderon kryetarin e Gjykatës Administrative të RSH, z. Kastriot Selita, për aksesin dhe akomodimin e shkëlqyer të monitoruesve të INFOÇIP për efekt të këtij vlerësimi.*

*INFOÇIP falenderon të gjithë kryetarët e gjykatave të rrethve gjyqësore që targetoi ky vlerësim tematik, të cilët mirëpritën ekipet monitoruese dhe lejuan akses në të dhënat që lidhen me kohën e shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimin e vendimeve.*

*INFOÇIP falenderon edhe kancelarët dhe sekretaret e gjykatave që për gjithë ndihmën dhe bashkëpunimin e ofruar në mbledhjen e të dhënave. Personeli i sekretarive gjyqësore u tregua gjithmonë i disponueshëm për të siguruar të dhënat e nevojshme, pavarësisht presionit të kohës dhe ngarkesës së punëve të përditshme.*

*Një falenderim i fundit, por i pari për nga rëndësia, shkon për National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C. USA që mbështeti INFOÇIP për realizimin e këtij monitorimi, në kushtet kur në Shqipëri, për shkak të Reformës në Drejtësi vlerësimet tematike janë ndërprerë deri në konsolidimin e institucioneve të reja që do të mbikqyrin sistemin gjyqësor.*

# KAPITULLI I

## OBJEKTI, LEGJITIMITETI

*1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.*
*2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.*
*3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.*

**Neni 142. Kushtetuta e Shqipërisë**

# MBI OBJEKTIVAT DHE RISITË E VLERËSIMIT TEMATIK, 2015

NGA **GERTI SHELLA**
*DREJTOR I STUDIMIT*

Vlerësimi Tematik për afatet e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatat Administrative të RSH realizohet për të dytin viti rradhazi me një shtrirje të plotë kombëtare. Të gjitha gjykatat administrative të rretheve gjyqësore, përfshirë Gjykatën e Apelit janë vlerësuar për kohëzgjatjen e shqyrtimit gjqësor dhe afatet e dorëzimit të dosjeve të vendimuara.

Për herë të parë, falë mbështetjes së ofruar nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C. USA, ky vlerësim tematik u aplikua edhe ndaj Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të RSH, për çështjet gjyqësore të vendimuara gjatë vitin 2015 dhe vitit 2016. Ky përfaqëson të parin dhe të vetmin vlerësim të këtij lloji që është ndërmarë ndonjëherë ndaj këtij Kolegji, madje edhe ndaj kësaj Gjykate nga aktorë të pavarur jashtë sistemit të gjykatave në RSH.

Metodologjia e Vlerësimit është dizenjuar nga INFOÇIP për të ofruar efikasitet maksimal në kontrastimin e afateve ligjore me të dhënat e regjistrave të gjykatave. Metoda bazohet 100% mbi evidenca dhe prodhon gjetje të cilat janë të verifikueshme.

Ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,* cakton afate të qarta sa i takon kohës së shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimit të vendimeve, duke dhënë mundësi konkrete për të realizuar matje referenciale sa i takon respektimit (tejkalimit) të këtyre afateve.

Kur flasim për drejtësinë administrative, afatet janë njëkohësisht mjeti dhe qëllimi për plotësimin e tiparit themelor të kësaj dege të gjyqësorit lloj: gjykim i shpejtë dhe pa zvarritje. Respektimi i afateve kohore është kusht për të interpretuar drejt qëllimin e ligjvënësit për një drejtësi pa vonesa, që garanton të drejtat e subjekteve (individuale ose juridike) ndaj arbitraritetit me të cilin i përball herë pas here administrata shtetërore. Jashtë afateve nuk ka drejtësi administrative efektive. Afatet e shpejta në gjykim kanë qenë në thelb nevoja që diktoi miratimin me ligj organik të këtij sistem special gjykatash në vitin 2012.

Në vitin 2014, për t'i ardhur në ndihmë vetë gjykatave të reja të krijuara, por dhe inspektoriateve respektive pranë KLD dhe Ministrisë së Drejtësisë, INFOCIP dizenjoi dhe pilotoi sistemin e vet të vlerësimit të afateve në vetëm dy gjykata, konkretisht gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit (në Tiranë). Vlerësimi i 2014-ës u limitua vetëm në monitorimin e afateve të dorëzimit të vendimeve në sekretarinë e gjykatës.

Një vit më pas, INFOÇIP ndërmori një vlerësim të dytë tematik, i cili zgjeroi jo vetëm gjeografinë e tij por edhe fokusin e monitorimit. Në vitin 2015, për herë të parë në vlerësim u futën të gjitha gjykatat administrative në vend, me përjashtim të Kolegjit Administrativ të GJL. Po ashtu për herë të parë u realizua matja e kohës së shqyrtimit gjyqësor duke kompletuar në këtë mënyrë mbulimin e plotë të spektrit kohor procedural të gjykimit nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatë e deri në dorëzimin e dosjes së vendimuar në sekretari. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, kohëzgjatja e një procesi gjyqësor, përllogaritet nga moment i depozitimit të kërkesës/padisë deri në dorëzimin e vendimit përfundimtar në sekretarinë e gjykatës

Në Vlerësimi Tematik për vitin 2016, i cili shpallet përmes këtij botimi, INFOÇIP përfshiu për herë të parë edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke kompletuar përfundimisht me monitorim jo vetëm të treja shkallët e shqyrtimit gjyqësor administrativ, por edhe të treja fazat e pilotimit të programit kombetar të Vlerësimit Tematik të gjykatave administrative të Shqipërisë.

Gjetjet për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë u shpallën nga INFOCIP në Gusht të vitit 2017. Ato caktuan një gur themeli në drejtim të vlerësimit të dhënave gjyqësore nga monitorues të pavarur për Gjykatën e Lartë, e cila përfaqëson majën e piramidës gjyqësore në Shqipëri dhe si e tillë ka qenë përtej rrezes së mbulimit institucional nga inspektoratet përkatëse. Vlerësimi tematik i ndërmarrë nga INFOÇIP për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë shënoi edhe të parin monitorim në kuadër të Reformës në Drejtësi, tashmë të aktivizuar në raport më organizimin e sistemit gjyqësor.

***

INFOÇIP, me ekpertizën dhe përvojën e gjerë të krijuar tashmë në vlerësimet tematike në sistemin gjyqësor, synon t'i vijë në ndihmë së pari trupës gjyqësore të GJA, duke i dhënë mundësi kësaj të fundit të njihet me rezultatet objektive dhe të nxjerrë konkluzionet përkatëse për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ky botim mund të kosiderohet një "auditim" i punës së tyre, i realizuar nga aktorë të specializuar dhe mbi të gjitha të pavarur, jashtë sistemit gjyqësor dhe jashtë sistemit qeveritar. Të dhënat janë përpunuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë përmes atributeve të vendimit edhe vlerësimin e kohëzgjatjes së çështjeve të vendimuara. Ky ushtrim mund të realizohet fare mirë nga cilido i interesuar përmes rakordimit të të dhënave të INFOÇIP me arkivat e vendimeve gjyqësor që administrohen nga vetë gjykatat. Kjo është një përmasë e re vlerësimi që e kapërcen hermetizmin që ka karakterizuar organet shtetërore që kanë për detyrë inspektimin e performancës së trupës gjyqësore. Në kushtet e reja të krijuara nga Reforma në Drejtësi, kur degët e tjera të pushteteve (psh Ministria e Drejtësisë) nuk kanë atribute të ndërmarrin kontrolle dhe vlerësime, ky mbetet i vetmi instrument kombëtar për momentin të parë me objektivitet të dhënat që gjeneron sistemi i gjykatave.

Për shkak të kushteve të reja të krijuara nga Reforma në Drejtësi, por edhe për shkak të ngarkesës specifike që kanë patur gjykatat administrative, funksionet institucionale të vetë-vlerësimit të performancës (raportet vjetore) nuk u aktivizuan plotësisht gjatë vitit 2016. Në këtë kuptim, ky raport vjetor që prezanton INFOÇIP përfaqëson intrumentin vlerësues kryesor që i vihet në dispozicion në rradhë të parë vetë gjykatave, por edhe institucioneve të reja të drejtësisë si dhe organizmave ndërkombëtare të interesuara për të njohur dhe vlerësuar në detaje efektëshmërinë e gjykimit administrativ në RSH gjatë vitit 2016. INFOÇIP fton gjykatat administrative që pasi të verifikojnë konsistencën e të dhënave ta adoptojnë këtë raport si pjesë e vlerësimit të punës së tyre.

Organet e reja të sistemit gjyqësor janë të mirëpritura gjithashtu që të disponojnë të dhënat që bëhen publike në këtë raport dhe, pasi t'i verifikojnë dhe konsolidojnë ato, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për adresimin e problematikës së identifikuar. INFOÇIP është i hapur për të ndërtuar një bashkëpunim me cilindo të interesuar brenda dhe/ose jashtë sistemit institucional gjyqësor apo më gjerë, me synim hartimin e politikave që rising efikasitetin dhe shkurtojnë afatet e gjyimit administrativ për qytetarët dhe bisneset. Studimi bazohet në gjetje konkrete dhe evidenca të matshme, të cilat ndihmojnë për të parë në thellësi problemet dhe rrjedhimisht edhe për të sjellë zgjidhjen e duhur të tyre, larg retorikës së padobishme dhe hamendësimeve.

***

Vlerësimet Tematike të realizuara nga INFOÇIP direfencojnë thelbësisht nga monitorimet me "kampionim" të aktorëve të tjerë institucionalë apo organizatave ndërkombëtare. Metoda e INFOÇIP nuk "filtron" 10 apo 20 çështje për të bërë më pas përgjithësime. Përkundrazi, INFOCIP analizon një për një, në varg të pandërprerë indeksues, vendimet gjyqësore, për periudhën kohore fikse (12 muaj në rastin konkret) duke garantuar koherencë dhe saktësi të lartë.

Për vitin 2016, INFOCIP analizuar të gjitha vendimet e themelit të dhëna nga të gjitha gjykatat administrative në vend dhe konkretisht 11738 vendime nga 6 GJA të rretheve të marra së bashku, 4738

vendime themeli të dhëna gjatë nga Gjykata Administrative e Apelit në 2016-ën. Për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, INFOÇIP analizoi 604 vendime përfundimtare për vitin 2016 dhe 710 vendime të dhëna në vitin 2015.

Për çdo vendim të dhënë është administruar dhe procesuar në format dixhital atributet e regjistrit, atributet e vendimit (datë dhe numër), koha e dorëzimit si dhe të dhëna të tjera të domosdoshme. Në total janë rreth 125530 të dhëna gjyqësore të analizuara për efekt të këtij monitorimi. Kjo përfaqëson edhe shifrën më të lartë të të dhënave të procesuara ndonjëherë në Shqipëri për efekt të një monitorimi gjyqësor. Në këtë kuptim, Vlerësimi Tematik 2016 cakton një rekord kombëtar dhe afirmon fuqinë dhe kapacitetin e shtuar të aktorëve të pavarur jo-qeveritarë brenda vendit për të përpunuar të dhëna gjyqësore komplekse dhe për të gjeneruar rezultate objektive. Aktualisht të dhënat e regjistrave të gjykatave në RSH mbahen kryesisht në letër (*paper based records*). Konvertimi i tyre në format dixhital, që lejon përpunimin e tyre, është në vetvete një arritje e shkëlqyer për të cilën INFOÇIP ka arsye legjitime të krenohet.

E fundit, por jo për nga rëndësia është fakti i aplikimit të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" për të marrë këto të dhëna gjyqësore. Ky shënon një tjetër moment kulmor të përdorimit të këtij instrumenti në sistemin e gjykatave administrative të RSH.

Shpresojmë që gjetjet e këtij Vlerësimi Tematik të realizuar nga INFOÇIP, me mbështetjen e rëndësishme të National Endowment for Democracy, me seli në Washington D.C. në SHBA, të shërbejnë për orientimin më të mirë të përpjekjeve në përmirësimin e sistemit gjyqësor administrativ, tashmë në kushtet e aktivizimit të Reformës në Drejtësi. Gjykatat Administrative kanë nevojë të përkrahen dhe të ndihmohen me burime njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për të përmbushur me cilësi dhe në afat **misionin për një drejtësi pa vonesa**, në mbrojtje të interesit legjitim të individit dhe subjekteve private përballë arbitraritetit shtetëror.

**Tiranë, Dhjetor, 2017**

# LEGJITIMITETI I MONITORIMIT, 2015

## BAZA LIGJORE PER AFATET E SHQYRTIMIN GJYQESOR & DOREZIMI I VENDIMEVE ADMINISTRATIVE

### I. MBI GJYKATAT ADMINISTRATIVE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Drejtësia administrative, si degë më vete e sistemit të gjykatave në Shqipëri, zë fill me miratimin e ligjit nr. 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*. Ky ligj është ndër pararendësit e Reformës në Drejtësi. Në relacionin shoqërues të projekt-aktit për Kuvendin thuhej shprehimisht në paragrafin e parë se *qëllimi i këtij ligji është reformimi i kuadrit të përgjithshëm ligjor administrativ në Shqipëri në kuadër të reformës në drejtësi.*

Krijimi i Gjykatës Administrative u motivua nga nevoja për garantimin e mbrojtjes efektive të interesave të ligjshme të subjekteve/personave nga arbitrariteti i administratës shtetërore, nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe *brenda afateve të shpejta e të arsyeshme*. Afatet janë ndër mjetet kryesore në arritjen e qëllimit për garantimin optimal të sigurisë juridike në kuadër të kësaj lloj drejtësie dhe përmes këtij ligji.

Në ndryshim nga Kodi i Procedurave Administrative në RSH, *ligji 49/2012, i ndryshuar* garanton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të personave nëpërmjet detyrimit që i vihet organeve publike të provojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes të veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre (*barra e provës i ngarkohet organeve publike*).

Shqyrtimi ligjor i vendimeve/akteve administrative nga gjykata të pavarura është një parim demokratik i pranishëm në praktikat kryesore evropiane dhe një kontribut i rëndësishëm për të siguruar rendin, veçanërisht **për të mbrojtur të drejtat e individit përballë administratës publike (shtetërore).**

Drejtësia administrative luan rol dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi. Pothuajse të gjitha vendimet për investime, projekte për infrastrukturën etj. duhet të kalojnë përmes një procesi licencimi, i cili mund të bëhet objekt shqyrtimi nga gjykatat administrative. Një sistem efikas i gjykatave administrative ndihmon në shtimin e transparencës administrative dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

Ndër kompetencat e gjykatave administrative është edhe kontrolli gjyqësor ndaj akteve të qeverisë dhe ekzekutivit në tërësi. Kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ që funksionon mirë rrit besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.

***

Njësoj si gjykatat e zakonshme, edhe ato administrative organizohen në tre shkallë: gjykatata e rretheve gjyqësore, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (një ndër tre kolegjet e kësaj gjykate).

Kompetencat tokësore, selia qëndrore, si dhe numri i gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit janë caktuar deri më tani me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, pasi ky i fundit merrte më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 6 gjykata administrative të shkallës së pare, të vendosura respektivisht në Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Ndërkohë, ka vetëm një Gjykatë Administrative Apeli për të gjithë R.SH dhe kjo është e vendosur në Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit ka patur fillimisht 7 gjyqtarë, deri në Janar 2016, kur numri i trupës gjyqësore u rrit në 13. Po ashtu edhe selia e kësaj gjykate është ndryshuar. Për shkak të kritereve ligjore të pa-vlerësuara mirë, trupa gjyqësore e gjykatave administrative të shkallës së parë ka mbetur e pa-plotësuar edhe 5 vjet pas miratimit të ligjit 49/2012. Në vlerësimet e INFOCIP, edhe sikur trupa gjyqësore të ishte e plotësuar 100%, përsëri ky do të ishte një numër i ulët gjyqtarësh krahasuar me ngarkesën në rritje të çështjeve që shqyrtohen nga ky sistem gjykatash në ditët e sotme. Gjykata Administrative Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër janë akoma me nga dy gjyqtarë që nga koha e krijimit të tyre, duke kompromentuar në këtë mënyrë eficiencën e sistemit në tërësi. Në parashikimet e reja ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi duhet që çdo gjykatë të ketëjo më pak se 7 gjyqtarë. Ky përcaktim normativ, në vlerësimin e INFOÇIP duhet të gjejë sa më parë zbatim në nivel të gjykatave administrative të rretheve gjyqësore.

## II. AFATET PROCEDURALE PËR SHQYRTIMIN GJYQËSOR ADMINISTRATIV

Një ndër tiparet kryesore të gjykimit administrativ është shpejtësia me të cilën ai duhet të realizohet. Afatet e shqyrtimit gjyqësor të veprimeve administrative fillojnë të ecin që në momentin kur individi i prekur njoftohet për veprimin administrativ dhe informohet saktësisht për të drejtat e tij/saj në lidhje me ankimin ose apelin.

Ligji 49/2012 bën përcaktime të sakta mbi afatet për depozitimin e kërkesë-padisë që janë jo më shumë se 10 ditësh nga dita e paraqitjes së padisë për të nxjerrë urdhërin për caktimin e seancës gjyqësore.

Ligj 49/2012 përcakton afate të qarta edhe për kryerjen e një sërë veprimesh përgatitore nga gjyqtari kryesues, veprime të cilat dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet edhe nga gjyqtari kryesues.

Ligji cakton një afat të përgjithshëm prej 10 ditësh për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, dhe vetëm në raste të veçanta dhe të justifikuara lejon përcaktimin e një afati më të gjatë. Në pjesën urdhëruese të vendimit përfundimtar gjykata duhet të përcaktojë afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit përkatës. Për shkak se studimi i INFOCIP përqëndrohet posacërisht në afatet e shqyrtimit gjyqësor dhe të dorëzimit të vendimeve, në këtë trajtesë do të ndalemi posaçërisht ne detajimin e këtyre të fundit.

Sa i takon kohës brenda së cilës duhet të realizohet dhe përmbyllet shqyrtimi gjyqësor, ligji ka përcaktuar afate strikte për shkallën e dytë dhe shkallën e tretë të gjykimit. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen **brenda 30 ditëve** nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur. Gjykata Administrative e Apelit dërgon dosjen në gjykatën administrative të shkallës së parë jo më vonë se 3 ditë pas kryerjes së njoftimit të vendimit të palëve (neni 48 pika 2 dhe 3)

Sa i takon dërgimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 60 *i ligjit 49/2012, i ndryshuar* bën gjithashtu pëcaktime të qarta. Gjykata administrative e shkallës së parë dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundër-rekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve. Gjykata e Lartë shqyrton çështjen **brenda 90 ditëve** nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

Ligji *49/2012 i ndryshuar*, nuk përshkruan e as vendos afat për shqyrtimin gjyqësor administrativ në shkallë të parë. INFOÇIP shpreh

keqardhjen që rekomandimet e tij për caktimin e një afati eksplicit nuk u morën  parasysh nga ligjvënësi në kuadër të ndryshimit të ligjit 49/2012 me ligjin nr. 39/2017.  Kjo është komentuar edhe më herët nga INFOÇIP  si një anomali e ligjit fillestar dhe tashmë si një e metë e ndryshimeve ligjore në kuadër të Reformës në drejtësi. Jo vetëm që "harresë" legjislative është përjashtim nga rregulli të cilit i nënshtrohen dy gjykatat e shkallëve më të larta, por ajo nuk reflekton as standartin e vjetër që aplikohej nga seksionet administrative të gjykatave të faktit në sistemin e zakonshëm gjyqësor. *Neni 327 i K.Pr.Civile, i shfuqizuar* përcaktonte se shqyrtimi i mosmarrëveshjes administrative duhet të përfundonte brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit në gjykatë. Në interpretimet zyrtare që janë dhënë për këtë anomali para Reformës pretendohej se mos-përshkrimi i një afti promovonte parimin e zhvillimit të gjykimit brenda afateve të arsyeshme pa dëmtuar cilësinë e drejtësisë dhe sidomos të drejtën e palëve për t'u mbrojtur efektivisht. Ky shpjegim gjithsesi nuk përkthen qëllimin e ligjvënësit për orientimin e gjykimit administrativ drejt afateve të shpejta dhe të përcaktuara ligjërisht.

Si rregull, gjykatat e një shkalle më të lartë, për shkak të volumit të çështjeve që mbledhin dhe shqyrtimit me trupë gjyqësore, kanë në dispozicion afate më të zgjeruara krahasuar me një gjykatë më të ulët. Për analogji, nëse afati i shqyrtimit gjyqësor për Gjykatën e Apelit Administrativ është 30 ditë nga depozitimi i padisë, ky afat është 90 ditë, pra trefish më i madh, për shqyrtimin gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (raport 1:3 nga një shkallë më ulët në një më të lartë).

Nëse do të aplikohej parimi i përcaktimit me analogji të një afati për shqyrtimin administrativ në shkallë të parë, ai do të duhet të ishte rreth 10 ditë (pra trefish më pak se afati 30-ditor i Gjykatës së Apelit). Kjo logjikë nuk është e panjohur për sistemin e gjykatave në vend. Megjithatë, nisur nga premisa se ligjvënësi ka caktuar në caktuar në l*igjin 49/2012, të ndryshuar* të njëjtin afat 7 ditor për dorëzimin e vendimit si për gjykatën administrative të Faktit ashtu dhe për atë të Apelit, në vlerësimin e autorëve të këtij studimi, afati për shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë mund të përllogaritet gjithashtu (për analogji) 30 ditë. Nuk do të kishte kuptim dhe as koherencë logjike që ky afat të ishte më i madh se sa ai në dispozicion të gjykatës që qëndron një shkallë më lartë, pra të Apelit Administrativ. Rrjedhimisht, në pamundësi për të kontrastuar gjetjet e studimit me një afat eksplicit të përcaktuar në ligjin 49/2012, të ndryshuar, INFOÇIP do të adoptojë këtë afat "maksimalist", pra 30 ditë, për vlerësimin e kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatat administrative të shkallës së parë.

## III. AFATET PËR DORËZIMIN E VENDIMIT GJYQËSOR ADMINISTRATIV

Në ligjin nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar,* parashikohet qartësisht forma e shpalljes së vendimit dhe afatet e dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore. **Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.**

Konkretisht, në nenin 42 të ligjit nr.49/2012 parashikohet se gjykatat administrative të shkallës së parë shpallin detyrimisht të arsyetuar vendimin gjyqësor. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Në rastet përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë.

Edhe për Gjykatën Administrative të Apelit aplikohen të njëjtat afate. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore (*neni 55*). Edhe këtu, në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, ajo e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor deri në 5 ditë.

Për shqyrtimin në Gjykatën e Lartë (*Kolegji Administrativ*), neni 64 ruan të njëjtën koherencë sa i takon formës së shpalljes: **vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.** Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Afatet (vonesat) në dorëzimin e dosjeve të vendimuara në sekretarinë e gjykatës janë objekt vlerësimi në këtë monitorim. Ato janë identifikuar saktësisht përmes sistemit të regjstrave të gjykatave, qofshin këta rregjistra themeltarë apo edhe regjistra alternativë të administruar nga kancelarët e gjykatave.

Sa i takon parashikimeve ligjore, INFOÇIP ka konstatuar një anomali, për të mos thnë një të metë që përmban ligji nr.49/2012, i ndryshuar teksa përcakton njëkohësisht se vendimi gjyqësor administrativ duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar dhe nga ana tjetër teksa cakton detyrimin e gjyqtarit / trupit gjykues ta dorëzojë dosjen e vendimuar pas 7 ditësh.

Sa i takon praktikës së administrimit gjyqësor, INFOÇIP ka konstatuar se sistemi i regjistrave të gjykatave administrative është i pa-unifikuar si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Kjo anomali duhet gjithashtu të adresohet me urgjencë, duke adoptuar një nga praktikat më të konsoliduara.

# KAPITULLI II

## GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK KOMBETARE

**MONITORIMI PER VITIN 2016**



# GJETJET E MONITORIMIT, 2016

## GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Gjykata Administrative e Apelit gjatë vitit 2016 e ushtroi aktivitetin e saj me një trupë gjyqësore prej 13 gjyqtarësh. Në fillim të vitin 2016, trupa gjyqësore e Gjykatës Administrative të Apelit u rrit me 7 gjyqtarë. Ky përbën një moment shumë të rëndësishëm jo vetëm në plotësimin e premisave bazë për mirë-funksionimin e kësaj gjykate, por edhe në raport me një ndër rekomandimet kryesore të INFOÇIP në kuadër të vlerësimit tematik për vitin 2015. Kryetari i kësaj Gjykate, Z. Kastriot Selita, ka advokuar institucionalisht dhe në vijueshmëri nevojën për shtimin e trupës gjyqësore në këtë gjykatë.

Gjatë vitit 2016, Gjykata Administrative e Apelit ka gjykuar dhe vendimuar 4738 çështje themeli. Me një mesatare të thjeshtëzuar, çdo gjyqtar gjatë vitit 2016 ka gjykuar dhe vendimuar rreth 365 çështje themeli ose thënë ndryshe, ka marrë një vendim themeli çdo ditë të vitit, përfshirë të shtunat dhe të djelat. Kjo shifër gjithsesi është më e madhe, pasi në këtë vlerësim tematik nuk analizohen vendimet e ndërmjetme, kërkesat etj. Emërimi i ndihmësve ligjorë (që në gjashtë-mujorin e dytë të 2015-ës) solli disa efekte pozitive, kryesisht në përgatitjen e çështjeve për gjykim si dhe në lehtësimin e gjyqtarëve për realizimin e arsyetimit të vendimeve brenda afateve ligjore.

Mbetet e nevojshme gjithsesi që çdo gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit të asistohet nga 2 ndihmës ligjorë dhe ndoshta edhe 3 në këtë fazë akute mbi-ngarkesë. Kjo është e diktuar nga volumi i punës që përballon çdo gjyqtar në këtë gjykatë. Vlerësohet se në kushtet aktuale, kjo gjykatë ka nevojë për të paktën 20 gjyqtarë, për të patur mundësi efektive për të reduktuar numrin e madh të dosjeve të akumuluara.

## KOHËZGJATJA E SHQYRTIMIT GJYQËSOR , 2016

Për efekt të këtij vlerësimi u mblodhën 4738 çështje gjyqësore themeli, vendimi për të cilat është dhënë në periudhën Janar–Dhjetor 2016. Prej tyre në analizë u futën 4657 vendime (83 vendime nuk u analizuan dot për shkak të pamundësisë për të identifikuar saktë atributet e hedhura me shkrim dore në regjistër). Brenda afatit prej 30 ditësh, gjatë vitit 2016 janë përfunduar vetëm 67 shqyrtime gjyqësore. Pjesa tjetër, 4590 çështje ose rreth 99% e totalit janë shqyrtuar përtej këtij afati.

| NR | FASHA KOHORE | NR I VENDIMEVE |
|---|---|---|
| 1 | 0 -30 dite | 67 |
| 2 | mbi 30 dite | 4590 |
| | TOTAL | 4657 |




***Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor gjatë vitit 2016 për çështje gjyqësore themeli në Gjykatën Administrative Apelit rezulton të jetë 589 ditë ose mesatarisht 1.6 vjet***

Tabela djathtas paraqet në fasha kohore më të detajuara kohëzgjatjen e shqyrtimit të dosjeve gjyqësore (çështje themeli) në GJA të Apelit.




**PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2016**

| Nr. | Fasha kohore në ditë | Nr vendimesh gjithsej | Shprehur në % |
|---|---|---|---|
| 1 | 0- 30 ditë | 67 | 1,44% |
| 2 | 31- 60 ditë | 26 | 0,56% |
| 3 | 61- 100 ditë | 46 | 0,99% |
| 4 | 101- 200 ditë | 71 | 1,53% |
| 5 | 201-300 ditë | 80 | 1,72% |
| 6 | 301-400 ditë | 106 | 2,28% |
| 7 | 401-500 ditë | 337 | 7,24% |
| 8 | mbi 500 ditë | 3922 | 84,25% |
| | TOTAL | 4657 | 100,00% |

INFOÇIP ka “filtruar” në një tabelë të posaçme edhe 30 çështjet që rezultojnë të kenë patur kohëzgjatjen më të madhe në shqyrtim gjatë 2016-ës. Kohëzgjatja në këtë rast nënkupton momentin nga regjistrimi i çështjes në gjykatë deri në mometin e dhënies së vendimit përfundimtar ne vitin 2016 (vetëm çështje themeli).

| VONËSAT ME EKSTREME NË SHQYRTIMIN E VENDIMEVE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Nr. vendimi | Data e rregjistrimit | Data e vendimit | Diferenca në dite | Vonësa pertej afatit ligjor 30 dite |
| 1 | 3899 | 21/1/2013 | 17/11/2016 | 1396 | 1366 |
| 2 | 1110 | 19/12/2012 | 11/5/2016 | 1239 | 1209 |
| 3 | 4536 | 13/1/2014 | 15/12/2016 | 1067 | 1037 |
| 4 | 4236 | 2/2/2014 | 5/12/2016 | 1037 | 1007 |
| 5 | 4263 | 16/2/2014 | 6/12/2016 | 1024 | 994 |
| 6 | 3731 | 22/2/2014 | 9/11/2016 | 991 | 961 |
| 7 | 2677 | 17/2/2014 | 21/9/2016 | 947 | 917 |
| 8 | 798 | 1/10/2013 | 20/4/2016 | 932 | 902 |
| 9 | 4402 | 10/6/2014 | 13/12/2016 | 917 | 887 |
| 10 | 4282 | 1/7/2014 | 7/12/2016 | 890 | 860 |
| 11 | 4679 | 17/7/2014 | 22/12/2016 | 889 | 859 |
| 12 | 4578 | 14/7/2014 | 16/12/2016 | 886 | 856 |
| 13 | 3790 | 12/6/2014 | 10/11/2016 | 882 | 852 |
| 14 | 3934 | 1/7/2014 | 17/11/2016 | 870 | 840 |
| 15 | 290 | 1/10/2013 | 18/2/2016 | 870 | 840 |
| 16 | 3985 | 17/7/2014 | 22/11/2016 | 859 | 829 |
| 17 | 3839 | 23/7/2014 | 15/11/2016 | 846 | 816 |
| 18 | 2654 | 27/5/2014 | 15/9/2016 | 842 | 812 |
| 19 | 3394 | 14/7/2014 | 25/10/2016 | 834 | 804 |
| 20 | 3549 | 17/7/2014 | 27/10/2016 | 833 | 803 |
| 21 | 996 | 4/2/2014 | 4/5/2016 | 820 | 790 |
| 22 | 2502 | 1/7/2014 | 14/9/2016 | 806 | 776 |
| 23 | 2463 | 1/7/2014 | 13/9/2016 | 805 | 775 |
| 24 | 3575 | 1/9/2014 | 10/11/2016 | 801 | 771 |
| 25 | 2033 | 28/4/2014 | 6/7/2016 | 800 | 770 |
| 26 | 2675 | 14/7/2014 | 20/9/2016 | 799 | 769 |
| 27 | 4690 | 16/10/2014 | 22/12/2016 | 798 | 768 |
| 28 | 1728 | 12/4/2014 | 17/6/2016 | 797 | 767 |
| 29 | 4575 | 13/10/2014 | 16/12/2016 | 795 | 765 |
| 30 | 4576 | 14/10/2014 | 16/12/2016 | 794 | 764 |

## DORËZIMI I DOSJEVE TË VENDIMUARA NE SEKRETARI

Për këtë vlerësim u analizuan 4632 vendime themeli nga një total prej 4738 vendimesh gjithsej të dhëna gjatë 2016-ës. Rezulton se brenda afatit 7-ditor janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit afërsisht **50%** (49.8%) e dosjeve të vendimuara (çështje themeli). Pjesa tjetër prej 2335 vendimesh dalin jashtë afatit ligjor. Periudha e analizuar është Janar-Dhjetor 2016. Kjo gjetje mund të interpretohet gjithashtu se, për vitin 2016, dispozitat e nenit 55 të ligjit 49/2012, *të ndryshuar,* kanë gjetur zbatim në masën **50%** në Gjykatën Administrative të Apelit.

| NR | FASHA KOHORE | NR. I VENDIMEVE |
|---|---|---|
| 1 | 0 deri 7 dite | 2297 |
| 2 | mbi 7 dite | 2335 |
| | TOTAL | 4632 |




***Shprehur në %***

***Për vitin 2016, dispozitat e nenit 55 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim në masën 50% në Gjykatën Administrative të Apelit, me seli në Tiranë.***

Tabela më poshtë paraqet në fasha kohore më të detajuara kohëzgjatjen e dorëzimit të vendimeve gjyqësore (çështje themeli) në GJA të Apelit.

| PERIUDHA E VLERESIMIT: JANAR-DHJETOR 2016 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Fasha Kohore në ditë | Nr. vendimesh gjithsej | Shprehur në % |
| 1 | 0-7 ditë | 2297 | 49,0% |
| 2 | 8-10 ditë | 1265 | 27,25% |
| 3 | 11-20 ditë | 812 | 17,47% |
| 4 | 21-30 ditë | 192 | 4,15% |
| 5 | 31-40 ditë | 33 | 1,38% |
| 6 | 41- 50 ditë | 24 | 0,56% |
| 7 | 51-100 ditë | 8 | 0,17% |
| 8 | mbi 100 ditë | 1 | 0,06% |
| | **TOTAL** | **4632** | **100%** |

## DOREZIMI I VENDIMEVE SIPAS FASHAVA KOHORE I VIZUALIZUAR

Grafiku me poshtë sugjeron qartësisht se grupi më i madh i dosjeve të vendimuara, rreth 57% janë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës brenda 10 ditësh nga dhënia e vendimit (pjesa blu dhe e kuqe e grafikut se bashku).




***Për vitin 2016, rreth 76% e dosjeve të vendimuara nga GJA Apelit janë dorëzuar në sekretarin brenda 10 ditësh***

## VONESAT MË EKSTREME NË DORËZIMIN E VENDIMEVE

Viti 2016 gjithashtu e ka përballur trupën gjyqësore të Apelit Administrativ me një ngarkesë të madhe. Kjo reflektohet edhe në kapjen e afteve për dorëzimin e vendimit. Vonesa më e madhe përtej afatit ligjor 7-ditor, e konstatuar për vitin 2016 është 94 ditë në dorëzim. Ky është vendimi nr. 2922 (shih tabelën në faqen pasardhëse). Gjatë gjithë vitit 2016, janë vetëm 3 vendime që kapin pragun e 90-ditëshit në dorëzim. Edhe vendimet e identifikuara si ekstreme në dorëzim, nuk e kapërcejnë në shumicën e tyre pragun 30 ditor dhe ky është një tregues pozitiv gjithsesi. Duhet theksuar se ky vlerësim është fokusuar vetëm në analizimin e çështjeve të themelit, duke përjashtuar çdo çështje të natyrave të tjera. Nëse do të përllogariteshin fjala vjen shqyrtimet e kërkesave, treguesit do të ishim të ndryshëm dhe padiskutim më pozitivë.

Tabela në faqen tjetër paraqet të grupuara 30 vendimet e dorëzuara me më shumë vonesë në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2016.

## VONËSAT ME EKSTREME NË DORËZIMIN E VENDIMEVE

| Nr. | Nr. vendimi | Date vendimi | Afat dorezimi | Diferenca në dite | Vonësa pertej afatit ligjor 7 dite |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2922 | 24/10/2016 | 2/2/2017 | 101 | 94 |
| 2 | 2923 | 30/9/2016 | 5/1/2017 | 97 | 90 |
| 3 | 3828 | 30/9/2016 | 9/1/2017 | 101 | 94 |
| 4 | 2294 | 18/7/2016 | 11/10/2016 | 85 | 78 |
| 5 | 2295 | 18/7/2016 | 11/10/2016 | 85 | 78 |
| 6 | 2665 | 19/9/2016 | 21/11/2016 | 63 | 56 |
| 7 | 2666 | 19/9/2016 | 16/11/2016 | 58 | 51 |
| 8 | 2662 | 19/9/2016 | 15/11/2016 | 57 | 50 |
| 9 | 3836 | 15/11/2016 | 6/1/2017 | 52 | 45 |
| 10 | 1840 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 11 | 1842 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 12 | 1843 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 13 | 1844 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 14 | 1845 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 15 | 1846 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 16 | 1847 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 17 | 1849 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 18 | 1852 | 23/6/2016 | 11/8/2016 | 49 | 42 |
| 19 | 3572 | 31/10/2016 | 14/12/2016 | 44 | 37 |
| 20 | 4725 | 27/12/2016 | 13/2/2017 | 48 | 41 |
| 21 | 2296 | 18/7/2016 | 29/8/2016 | 42 | 35 |
| 22 | 2297 | 18/7/2016 | 29/8/2016 | 42 | 35 |
| 23 | 2298 | 18/7/2016 | 29/8/2016 | 42 | 35 |
| 24 | 2299 | 18/7/2016 | 29/8/2016 | 42 | 35 |
| 25 | 2405 | 21/7/2016 | 1/9/2016 | 42 | 35 |
| 26 | 2412 | 21/7/2016 | 1/9/2016 | 42 | 35 |
| 27 | 2656 | 19/9/2016 | 31/10/2016 | 42 | 35 |
| 28 | 2658 | 19/9/2016 | 31/10/2016 | 42 | 35 |
| 29 | 3570 | 31/10/2016 | 12/12/2016 | 42 | 35 |
| 30 | 3571 | 31/10/2016 | 12/12/2016 | 42 | 35 |

## KRAHASIMI 2016 -2015 - SHQYRTIMI GJYQËSOR NË GJYKATËN E APELIT

Treguesi SHDA (*Shqyrtimi i Dosjes Administrative*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekpertët e INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. Ai pasqyrohet në pikë përqindje. SHDA përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve te vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari. Në këtë rast ai indeksohet si "**SHDA vertikal**", për ta dalluar atë nga "**SHDA horizontal**", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Në rastin e Gjykatës Administrative të Apelit, në analizë futen treguesit e shqyrtimit brenda afatit 30-ditor të çështjeve të themelit. Të dhënat janë krahasuar vetëm për 6-mujorin e dytë të vitit, respektivisht 2015 dhe 2016.







***Treguesi SHDA shënoi një rënie prej 8 % për vitin 2016***

Sikurse sugjeron edhe grafiku *majtas* , gjatë vitit 2016 Gjykata Administrative e Apelit e ka dobësuar treguesit dorëzimit e shqyrtimit të dosjeve brenda afatit 30-ditor me rreth 8 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2015 (vetem 6-mujori dyte i vitit marre në analize krahasuese)

## GJA E APELIT - KRAHASIMI 2016 -2015, DOREZIMIN NE AFAT I VENDIMEVE

Treguesi DAV (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga INFOÇIP për të indikuar progresin/regresin efektshmërisë gjyqësore nga viti në vit. Ai pasqyrohet në pikë përqindje. DAV përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve të vitit aktual dhe vitit paraardhës Në këtë rast ai indeksohet si "**DAV vertikal**", për ta dalluar atë nga "**DAV horizontal**", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Në kuadër të këtij studimi, në analizë futen treguesit e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore themelit dhe të dorëzimit të vendimeve respektive në sekretarinë e gjykatës. Baza e krahasueshmërisë për gjykatën e Apelit është përiudha Korrik-Dhjetor, përkatësist viti 2015 dhe 2016. Për gjykatata e shkallëve më të ulëta është peridha Shtator -Dhjetor 2015 dhe 2016 (4 muaj). Për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, krahasueshmërisë ka qenë e plotë për vitin 2015 dhe 2016 (12 muaj)







***Treguesi DAV vertikal shënoi një rritje prej 6 % për vitin 2016***

| 7 | 103 | 15-3-2016 | 23-3-2016 | 8 | 1 |
| 8 | 151 | 19-4-2016 | 27-4-2016 | 8 | 1 |
| 9 | 192 | 10-5-2016 | 18-5-2016 | 8 | 1 |
| 10 | 193 | 11-5-2016 | 19-5-2016 | 8 | 1 |
| 11 | 199 | 12-5-2016 | 20-5-2016 | 8 | 1 |
| 12 | 344 | 13-7-2016 | 21-7-2016 | 8 | 1 |
| 13 | 346 | 13-7-2016 | 21-7-2016 | 8 | 1 |
| 14 | 592 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 15 | 593 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 16 | 594 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 17 | 595 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 18 | 596 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 19 | 597 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 20 | 598 | 1-12-2016 | 9-12-2016 | 8 | 1 |
| 21 | 636 | 15-12-2016 | 23-12-2016 | 8 | 1 |



# GJETJET E MONITORIMIT, 2016

## GJYKATA ADMINISTRATIVE E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

### KOHËZGJATJA E SHQYRTIMIT GJYQËSOR

Për efekt të kësaj analize u vlerësuan 2182 çështje gjyqësore themeli, vendimi për të cilat është dhënë në periudhën Janar –Dhjetor 2016. Në total u administruan nga kjo gjykatë 2215 çështje të cilat rezultojnë të vendimuara në vitin 2016, por për 33 prej tyre të dhënat e regjistrit ishin të palexueshme për vlerësuesit e INFOÇIP. Vlen të theksohet se të dhënat e analizuar për GJA Vlorë mund të kenë marzh gabimi rreth 2.5% krahasuar me vetëm 1.5% që është rregulli për gjykatat e tjera.

Rezulton se, brenda afatit prej 30 ditësh janë përfunduar së shqyrtuari 147 çështje gjyqësore themeli (7% e totalit). Pjesa tjetër, 2035 çështje ose rreth 93% e totalit, janë shqyrtuar përtej këtij afati.

| NR | FASHA KOHORE | VENDIME |
|---|---|---|
| 1 | 0-30 ditë | 147 |
| 2 | mbi 30 ditë | 2035 |
| | TOTAL | 2182 |




***Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë rezulton të 73 ditë (çështje gjyqësore themeli).***

Për të indikuar edhe më qartësisht gjetjet, INFOÇIP ka grupuar matjet për ***fashën kohore 30 ditore dhe 100 ditore***, si dy pragje kohore tipike që mund të vizualizojnë më mirë shpërndarjen e çështjeve gjyqësore administrative të themelit në GJA të Vlorës gjatë vitit 2016.




| PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2016 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Fasha kohore në ditë | Nr. vendimesh gjithsej | Shprehur në % |
| 1 | 0- 30 | 147 | 6.7% |
| 2 | 31- 60 | 964 | 44.2% |
| 3 | 61- 100 | 736 | 33.7% |
| 4 | 101- 200 | 285 | 13.1% |
| 5 | 201-300 | 31 | 1.4% |
| 6 | 301-400 | 11 | 0.5% |
| 7 | 401-500 | 7 | 0.3% |
| 8 | mbi 500 | 2 | 0.1% |
| | TOTAL | 2183 | 100% |

***Shumica e çështeve të vendimuara në vitin 2016 nga GJA Vlorë grupohen në fashën kohore nga 31-60 ditë***

Nëse do t'i ri-gruponim të dhënat e monitorimit në dy kategori: çështje të shqyrtuara brenda 100 ditësh nga momenti i regjistrimit në gjykatë dhe çështje/dosje të shqyrtuara përtej 100 ditësh, do të kishim këtë vizualizim të ri:



Tabela më poshtë rendit 30 çështjet e themelit që rezultojnë të kenë patur kohëzgjatjen më të madhe në shqyrtim gjatë intervalit 4-mujor Shtator-Dhjetor 2015 në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Vlorë.

| VONESAT ME EKSTREME NË SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQESORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nr. vendimi | Data e rregjistrimit | Data e vendimit | Diferenca në dite | Përtej 30 ditë |
| 1 | 848 | 29-9-2014 | 30-5-2016 | 609 | 579 |
| 2 | 823 | 3-10-2014 | 25-5-2016 | 600 | 570 |
| 3 | 2214 | 15-9-2015 | 28-12-2016 | 470 | 440 |
| 4 | 2213 | 21-10-2015 | 28-12-2016 | 434 | 404 |
| 5 | 392 | 9-2-2015 | 24-3-2016 | 409 | 379 |
| 6 | 391 | 11-2-2015 | 24-3-2016 | 407 | 377 |
| 7 | 261 | 20-1-2015 | 1-3-2016 | 406 | 376 |
| 8 | 390 | 15-2-2015 | 24-3-2016 | 403 | 373 |
| 9 | 197 | 18-1-2015 | 23-2-2016 | 401 | 371 |
| 10 | 247 | 1-2-2015 | 1-3-2016 | 394 | 364 |
| 11 | 400 | 4-3-2015 | 29-3-2016 | 391 | 361 |
| 12 | 83 | 29-1-2015 | 2-2-2016 | 369 | 339 |
| 13 | 17 | 12-11-2015 | 5-11-2016 | 359 | 329 |
| 14 | 15 | 17-11-2015 | 5-11-2016 | 354 | 324 |
| 15 | 16 | 18-11-2015 | 5-11-2016 | 353 | 323 |
| 16 | 525 | 29-4-2015 | 13-4-2016 | 350 | 320 |
| 17 | 2078 | 12-1-2016 | 13-12-2016 | 336 | 306 |
| 18 | 653 | 29-5-2015 | 28-4-2016 | 335 | 305 |
| 19 | 697 | 22-6-2015 | 9-5-2016 | 322 | 292 |
| 20 | 1993 | 4-2-2016 | 5-12-2016 | 305 | 275 |
| 21 | 36 | 10-4-2015 | 19-1-2016 | 284 | 254 |
| 22 | 20 | 7-4-2015 | 8-1-2016 | 276 | 246 |
| 23 | 315 | 11-6-2015 | 10-3-2016 | 273 | 243 |
| 24 | 847 | 25-9-2015 | 30-5-2016 | 248 | 218 |
| 25 | 123 | 11-6-2015 | 9-2-2016 | 243 | 213 |
| 26 | 1846 | 16-3-2016 | 14-11-2016 | 243 | 213 |
| 27 | 1890 | 21-3-2016 | 17-11-2016 | 241 | 211 |
| 28 | 105 | 10-6-2015 | 5-2-2016 | 240 | 210 |
| 29 | 211 | 30-6-2015 | 23-2-2016 | 238 | 208 |
| 30 | 2118 | 21-4-2016 | 15-12-2016 | 238 | 208 |

## DORËZIMI I VENDIMEVE

Nga vlerësimi rezulton se, brenda afatit ligjor prej 7 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës Administrative Vlorë **91%** e totalit prej 1316 vendimesh të analizuara për efekt të këtij Vlerësimi. Duhet theksuar se në të dhënat e disponuara nga INFOÇIP, datat e dorëzimit të vendimeve rezultojnë të mbajtura në regjistra alternative, një për çdo gjykatës. INFOÇIP ka disponuar të dhëna vetëm për dy gjykatës në rastin konkret. Metodologjikisht kjo e dhënë është përgjithësuese për gjithë vitin 2016 në kuadër të Vlerësimi për GJA Vlorë.

| NR | FASHA KOHORE | VENDIME |
|---|---|---|
| 1 | 0 deri 7 dite | 1199 |
| 2 | mbi 7 dite | 117 |
| | TOTAL | 1316 |




***Për vitin 2016, dispozitat e nenit 42 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim në masën 91% në Gjykatën Administrative të Rrethit Vlorë.***

Tabela më poshtë dhe grafiku ofron një pamje të afateve të dorëzimit të vendimeve te analizuara sipas fashave kohore (më e larta "mbi 100" ditë).

| PERIUDHA E VLERESIMIT E VITIT 2016 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Fasha kohore në ditë** | **Nr vendimesh gjithsej** | **Shprehur në %** |
| 1 | 0-7 ditë | 1199 | 91.1% |
| 2 | 8-10 ditë | 108 | 8.2% |
| 3 | 11-20 ditë | 3 | 0.2% |
| 4 | 21-30 ditë | 0 | 0.0% |
| 5 | 31-40 ditë | 2 | 0.2% |
| 6 | 41- 50 ditë | 0 | 0.0% |
| 7 | 51-100 ditë | 1 | 0.1% |
| 8 | mbi 100 ditë | 3 | 0.2% |
| | **TOTAL** | **1316** | **100%** |




***Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit të vendimit në sekretari për periudhën e marrë në analizë është 6.1 ditë***

Për të indikuar edhe më qartësisht gjetjet, INFOCIP ka sintetizuar matje edhe për ***fashën kohore 10 ditore***, e cila është përgjithësuese, po të mbahet parasysh edhe struktura e javës së punës, ku fundjava mund të akumulojë çështje të cilat, për arsye objektive nuk mund të administrohen nga sekretaritë e gjykatave.

Rezulton se, brenda afatit 10 ditor, në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë janë dorëzuar rreth 99% e totalit prej 1316 vendimesh të analizuara nga ky studim (grafiku djathtas). Ky është një tregues që flet pozitivisht në favor të performancës së trupës gjyqësore të kësaj gjykate.



Ndërkohe, 30 dosjet/vendimet që rezultojnë të kenë patur vonesat më te shprehura në dorëzim gjatë 2016-ës në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Vlorë grupohen në tabelen më poshtë (*periudha e vlerësimit: Janar-Dhjetor 2016*).

**VONESAT ME EKSTREME NË DORËZIMIN E DOSJEVE TË VENDIMUARA**

| Nr. | Nr. vendimi | Date vendimi | Afat dorezimi | Diferenca në dite | Vonesa pertej afatit ligjor 7 dite |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 460 | 4-4-2016 | 12-10-2016 | 191 | 184 |
| 2 | 462 | 5-4-2016 | 30-9-2016 | 178 | 171 |
| 3 | 363 | 17-3-2016 | 15-7-2016 | 120 | 113 |
| 4 | 176 | 18-2-2016 | 11-4-2016 | 53 | 46 |
| 5 | 151 | 15-2-2016 | 19-3-2016 | 33 | 26 |
| 6 | 1371 | 27-6-2016 | 30-7-2016 | 33 | 26 |
| 7 | 30 | 19-1-2016 | 5-2-2016 | 17 | 10 |
| 8 | 37 | 19-1-2016 | 4-2-2016 | 16 | 9 |
| 9 | 1650 | 13-10-2016 | 24-10-2016 | 11 | 4 |
| 10 | 164 | 16-2-2016 | 26-2-2016 | 10 | 3 |
| 11 | 1151 | 4-7-2016 | 14-7-2016 | 10 | 3 |
| 12 | 1504 | 23-9-2016 | 3-10-2016 | 10 | 3 |
| 13 | 1505 | 23-9-2016 | 3-10-2016 | 10 | 3 |
| 14 | 1506 | 23-9-2016 | 3-10-2016 | 10 | 3 |
| 15 | 1507 | 23-9-2016 | 3-10-2016 | 10 | 3 |
| 16 | 1508 | 23-9-2016 | 3-10-2016 | 10 | 3 |
| 17 | 173 | 17-2-2016 | 26-2-2016 | 9 | 2 |
| 18 | 247 | 1-3-2016 | 10-3-2016 | 9 | 2 |
| 19 | 1898 | 21-11-2016 | 30-11-2016 | 9 | 2 |
| 20 | 2135 | 19-12-2016 | 28-12-2016 | 9 | 2 |
| 21 | 2211 | 27-12-2016 | 5-1-2017 | 9 | 2 |
| 22 | 227 | 25-2-2016 | 4-3-2016 | 8 | 1 |
| 23 | 228 | 25-2-2016 | 4-3-2016 | 8 | 1 |
| 24 | 229 | 25-2-2016 | 4-3-2016 | 8 | 1 |
| 25 | 230 | 25-2-2016 | 4-3-2016 | 8 | 1 |
| 26 | 239 | 26-2-2016 | 5-3-2016 | 8 | 1 |
| 27 | 240 | 26-2-2016 | 5-3-2016 | 8 | 1 |
| 28 | 241 | 26-2-2016 | 5-3-2016 | 8 | 1 |
| 29 | 269 | 2-3-2016 | 10-3-2016 | 8 | 1 |
| 30 | 270 | 2-3-2016 | 10-3-2016 | 8 | 1 |



# GJETJET E MONITORIMIT, 2016
## GJYKATA ADMINISTRATIVE E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

### KOHËZGJATJA E SHQYRTIMIT GJYQËSOR

Për efekt të kësaj analize u mblodhën 1153 çështje gjyqësore themeli, vendimi për të cilat është dhënë nga Janari ne Dhjetor 2016. prej tyre në analizë u futën 1150 (3 vendime kishin të dhëna të palexueshme në regjistër).

Rezulton se, gjatë 2016-ës brenda afatit 30 ditor janë shqyrtuar vetëm 41 çështje gjyqësore themeli. Pjesa tjetër, 1109 çështje ose rreth 97 % e totalit, janë përfunduar së shqyrtuari përtej këtij afati.

| NR | FASHA | VENDIME |
|---|---|---|
| 1 | 0-30 ditë | 41 |
| 2 | mbi 30 ditë | 1109 |
| | TOTAL | 1150 |




***Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë rezulton të jetë rreth 140.6 ditë (vetëm çështje gjyqësore themeli).***

Për të indikuar edhe më qartësisht gjetjet, INFOÇIP ka grupuar matjet për ***fashën kohore 30 ditore dhe 100 ditore***, si dy pragje kohore tipike që mund të vizualizojnë më mirë shpërndarjen e çështjeve gjyqësore administrative të themelit në GJA Durrës gjatë vitit 2016.




| PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2016 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Fasha kohore në ditë | Nr. vendimesh gjithsej | Shprehur në % |
| 1 | 0- 30 | 41 | 3.6% |
| 2 | 31- 60 | 93 | 8.1% |
| 3 | 61- 100 | 318 | 27.6% |
| 4 | 101- 200 | 506 | 44% |
| 5 | 201-300 | 139 | 12.1% |
| 6 | 301-400 | 31 | 2.7% |
| 7 | 401-500 | 3 | 0.3% |
| 8 | mbi 500 | 20 | 1.7 % |
| | **TOTAL** | **1151** | **100%** |

***Shumica e çështjeve të vendimuara në 2016 janë përfunduar në 100 ditëshin e dytë nga momenti i regjistrimit në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Durrës***

Nëse do t'i ri-gruponim të dhënat e monitorimit në dy kategori: çështje të shqyrtuara brenda 100 ditësh nga momenti i regjistrimit në gjykatë dhe çështje/dosje të shqyrtuara përtej 100 ditësh, do të kishim këtë vizualizim të ri:



Tabela më poshtë rendit 30 çështjet e themelit që rezultojnë të kenë patur kohëzgjatjen më të madhe në shqyrtim (të vendimuara gjatë viti 2016 në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Durrës.

| VONESAT ME EKSTREME NË SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQESORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nr. vendimi | Data e rregjistrimit | Data e vendimit | Diferenca në dite | Përtej 30 ditë |
| 1 | 241 | 4-12-2013 | 16-3-2016 | 833 | 803 |
| 2 | 726 | 16-5-2014 | 20-7-2016 | 796 | 766 |
| 3 | 461 | 6-5-2014 | 20-5-2016 | 745 | 715 |
| 4 | 913 | 27-10-2014 | 24-10-2016 | 728 | 698 |
| 5 | 610 | 15-7-2014 | 28-6-2016 | 714 | 684 |
| 6 | 357 | 28-5-2014 | 22-4-2016 | 695 | 665 |
| 7 | 1123 | 29-1-2015 | 22-12-2016 | 693 | 663 |
| 8 | 727 | 5-9-2014 | 20-7-2016 | 684 | 654 |
| 9 | 245 | 5-5-2014 | 17-3-2016 | 682 | 652 |
| 10 | 715 | 12-9-2014 | 18-7-2016 | 675 | 645 |
| 11 | 736 | 22-9-2014 | 21-7-2016 | 668 | 638 |
| 12 | 609 | 22-9-2014 | 28-6-2016 | 645 | 615 |
| 13 | 154 | 18-3-2014 | 19-2-2016 | 703 | 673 |
| 14 | 557 | 17-9-2014 | 17-6-2016 | 639 | 609 |
| 15 | 172 | 10-6-2014 | 25-2-2016 | 625 | 595 |
| 16 | 362 | 12-9-2014 | 26-4-2016 | 592 | 562 |
| 17 | 344 | 17-9-2014 | 19-4-2016 | 580 | 550 |
| 18 | 462 | 27-10-2014 | 20-5-2016 | 571 | 541 |
| 19 | 504 | 22-9-2014 | 3-6-2016 | 620 | 590 |
| 20 | 613 | 22-1-2015 | 28-6-2016 | 523 | 493 |
| 21 | 523 | 5-2-2015 | 8-6-2016 | 489 | 459 |
| 22 | 266 | 29-1-2015 | 25-3-2016 | 421 | 391 |
| 23 | 1061 | 22-10-2015 | 2-12-2016 | 407 | 377 |
| 24 | 1139 | 27-11-2015 | 27-12-2016 | 396 | 366 |
| 25 | 334 | 20-1-2015 | 15-4-2016 | 451 | 421 |
| 26 | 623 | 15-6-2015 | 29-6-2016 | 380 | 350 |
| 27 | 1130 | 9-12-2015 | 22-12-2016 | 379 | 349 |
| 28 | 1137 | 16-12-2015 | 27-12-2016 | 377 | 347 |
| 29 | 326 | 4-11-2015 | 13-4-2016 | 161 | 131 |
| 30 | 28 | 9-1-2015 | 18-1-2016 | 374 | 344 |

## DORËZIMI I VENDIMEVE SIPAS AFATIT LIGJOR (7 DITE) NE GJA DURRES

Nga vlerësimi rezulton se, brenda afatit ligjor prej 7 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës Administrative Durrës **63%** e totalit prej 393 vendimesh të analizuara për efekt të këtij Vlerësimi. Duhet theksuar se në të dhënat e disponuara nga INFOÇIP datat e dorëzimit të vendimeve rezultojnë të mbajtura në registra alternative, një për cdo gjykatës. INFOÇIP ka disponuar të dhëna vetëm për dy gjykatës në rastin konkret. Metodologjikisht kjo e dhënë është përgjithësuese për gjithë vitin 2016 në kuadër të Vlerësimi për GJA Durrës.

| NR | FASHA KOHORE | NR I VENDIMEVE |
|---|---|---|
| 1 | 0 deri 7 dite | 147 |
| 2 | mbi 7 dite | 246 |
| | TOTAL | 393 |




Tabela më poshtë dhe grafiku shoqërues ofron një pamje të kohëzgjatjes së dorëzimit të vendimeve sipas fushave kohore 10 ditore. Dallohet qartësisht se në fashën kohore midis 8 deri 10 ditë janë grupuar më shumë dosje të vendimuara të cilat janë dorëzuar në sekretarinë e kësaj gjykate, krahasuar me intervalin tjetër 0-7 ditë.

| PERIUDHA E VLERESIMIT E VITIT 2016 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Fasha Kohore në ditë | Nr. vendimesh gjithsej | Shprehur në % |
| 1 | 0-7 ditë | 147 | 37,4% |
| 2 | 8-10 ditë | 224 | 57,00% |
| 3 | 11-20 ditë | 22 | 5,60% |
| 4 | 21-30 ditë | 0 | 0,00% |
| 5 | 31-40 ditë | 0 | 0,00% |
| 6 | 41- 50 ditë | 0 | 0,00% |
| 7 | 51-100 ditë | 0 | 0,00% |
| 8 | mbi 100 ditë | 0 | 0,00% |
| | **Total** | **393** | **100%** |




***Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit të vendimit në sekretari për vitin 2016 është 7.7 ditë (vetëm 2 gjyqtarë të analizuar)***

Për të indikuar edhe më qartësisht gjetjet, INFOCIP ka sintetizuar matje edhe për ***fashën kohore 10 ditore***, e cila është përgjithësuese, po të mbahet parasysh edhe struktura e javës së punës, ku fundjava mund të akumulojë çështje të cilat, për arsye objektive nuk mund të administrohen nga sekretaritë e gjykatave.

Rezulton se, brenda afatit 10 ditor, në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës janë dorëzuar rreth 94% e totalit prej 393 vendimesh të analizuara nga ky studim (grafiku djathtas). Ky është një tregues që flet pozitivisht në favor të performancës së trupës gjyqësore të kësaj gjykate.



Ndërkohe, 30 dosjet/vendimet që rezultojnë të kenë patur vonesat më te shprehura në dorëzim gjatë 2016-ës në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Durrës grupohen në tabelen me poshtë (*periudha e vlerësimit: Janar-Dhjetor 2016*).

| VONESAT ME EKSTREME NË DORËZIMIN E DOSJEVE TË VENDIMUARA | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Nr. vendimi** | **Date vendimi** | **Diferenca në dite** | **Vonesa pertej afatit ligjor 7 dite** |
| 1 | 159 | 22-2-2016 | 15 | 8 |
| 2 | 188 | 1-3-2016 | 15 | 8 |
| 3 | 189 | 1-3-2016 | 15 | 8 |
| 4 | 230 | 11-3-2016 | 15 | 8 |
| 5 | 417 | 9-5-2016 | 15 | 8 |
| 6 | 432 | 11-5-2016 | 15 | 8 |
| 7 | 479 | 27-5-2016 | 15 | 8 |
| 8 | 571 | 20-6-2016 | 15 | 8 |
| 9 | 755 | 9-9-2016 | 15 | 8 |
| 10 | 766 | 14-9-2016 | 15 | 8 |
| 11 | 415 | 9-5-2016 | 13 | 6 |
| 12 | 20 | 18-1-2016 | 12 | 5 |
| 13 | 180 | 29-2-2016 | 12 | 5 |
| 14 | 211 | 7-3-2016 | 12 | 5 |
| 15 | 337 | 18-4-2016 | 12 | 5 |
| 16 | 356 | 21-4-2016 | 12 | 5 |
| 17 | 383 | 28-4-2016 | 12 | 5 |
| 18 | 526 | 8-6-2016 | 12 | 5 |
| 19 | 537 | 14-6-2016 | 12 | 5 |
| 20 | 572 | 20-6-2016 | 12 | 5 |
| 21 | 722 | 20-7-2016 | 12 | 5 |
| 22 | 767 | 14-9-2016 | 12 | 5 |
| 23 | 28 | 18-1-2016 | 10 | 3 |
| 24 | 294 | 5-4-2016 | 10 | 3 |
| 25 | 413 | 9-5-2016 | 10 | 3 |
| 26 | 524 | 8-6-2016 | 10 | 3 |
| 27 | 710 | 14-7-2016 | 10 | 3 |
| 28 | 768 | 14-9-2016 | 10 | 3 |
| 29 | 296 | 5-4-2016 | 9 | 2 |
| 30 | 376 | 28-4-2016 | 9 | 2 |


Nr. vendimit
DATA
Nr. Rregjstrit
DATA E ARDHJES
PADITES I PADITURI
OBJEKTI
DISPOZITIVI
GJYQTARI
SEANCA
APELI
GJYKATA E

# KAPITULLI III

## ANALIZA KRAHASUESE

## 2016-2015



# ANALIZA KRAHASUESE

## GJYKATAT ADMINISTRATIVE TE RRETHEVE

**Treguesi SHDA** (*Shqyrtimi i Dosjes Administrative*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekpertët e INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. Ai pasqyrohet në pikë përqindje. SHDA përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve te vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari. Në këtë rast ai indeksohet si "**SHDA vertikal**", për ta dalluar atë nga "**SHDA horizontal**", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit. Në rastin e gjykatave administrative të rretheve gjyqësore, në analizë futen treguesit e shqyrtimit brenda 30-ditëshit të çështjeve të themelit. Ky nuk është një afat ekplicit në ligj, sikurse është për GJA të Apelit, por një afat i referuar si "i duhur" nga analogjia he nga praktika e vlerësimit të performacës së gjykajtave/gjyqtarëve nga KLD Të dhënat janë krahasuar vetëm për 4-mujorin e tretë të vitit, respektivisht 2015 dhe 2016.

**Treguesi DAV** (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është një indikator tjetër i konceptuar nga INFOÇIP. Edhe ai pasqyrohet në pikë përqindje. DAV përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve të vitit aktual dhe vitit paraardhës Në këtë rast ai indeksohet si "**DAV vertikal**", për ta dalluar atë nga "**DAV horizontal**", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Baza e krahasueshmërisë për gjykatën e Apelit është përiudha Korrik-Dhjetor, përkatësist viti 2015 dhe 2016. Për gjykatat e shkallëve më të ulëta është peridha Shtator -Dhjetor 2015 dhe 2016 (4 muaj). Për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, krahasueshmërisë ka qenë e plotë për vitin 2015 dhe 2016 (12 muaj)

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR, TIRANË

## SHQYRTIMI GJYQËSOR, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)

Për efekt të këtij vlerësimi special, janë krahasuar treguesit e performancës së GJA të Tiranës për periudhën Shtator-Dhjetor 2015 dhe Shtator -Dhjetor 2016, për efekt të ekuivalentimit të bazës së krahasueshmërisë me studimin e vitit të kaluar të ndërmarrë nga INFOÇIP.







***Treguesi SHDA vertikal shënoi rënie prej 4% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR, TIRANË

## DOREZIMI I VENDIMEVE, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi DAV vertikal shënoi rënie prej 9.5% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR SHKODËR

## SHQYRTIMI GJYQËSOR, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi SHDA vertikal shënoi rritje prej 2% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR SHKODËR

## DOREZIMI I VENDIMEVE, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







**Treguesi DAV vertikal shënoi rritje prej 1% për 4-mujorin III të 2016-ës**

# GJYKATA ADMINISTRATIVE RR. GJYQËSOR, GJIROKASTËR

## SHQYRTIMI GJYQËSOR - KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi SHDA vertikal shënoi rënie prej 6% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE RR. GJYQËSOR, GJIROKASTËR

## DOREZIMI I VENDIMEVE, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi DAV vertikal shënoi rënie prej 5% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR KORÇË

## SHQYRTIMI GJYQËSOR, - KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)




***Treguesi SHDA vertikal shënoi rritje prej 8% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR KORÇË

## DOREZIMI I VENDIMEVE, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi DAV vertikal shënoi rritje prej 4% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE , RRETHI GJYQËSOR VLORË

## SHQYRTIMI GJYQËSOR - KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi SHDA vertikal shënoi rritje prej 15% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE , RRETHI GJYQËSOR VLORË

## DOREZIMI I VENDIMEVE, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi DAV vertikal shënoi rritje prej 55% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR DURRËS

## SHQYRTIMI GJYQËSOR - KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi SHDA vertikal shënoi rënie prej 4% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# GJYKATA ADMINISTRATIVE, RRETHI GJYQËSOR DURRËS

## DOREZIMI I VENDIMEVE, KRAHASIMI 2015-2016, (SHTATOR-DHJETOR)







***Treguesi DAV vertikal shënoi rënie prej 78% për 4-mujorin III të 2016-ës***

# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE, TREGUESIT VJETORE, 2016

Gjatë vitit 2016 gjykatat administrative në RSH shqyrtuan një volum relativisht të lartë çështjes gjyqësore. Volumin më të madh të ngarkesës e përballoi Gjykata Administrative e Apelit, e vetmja në Shqipëri (me seli në Tiranë). Volum relativisht të madh përballuan dhe gjykatat e Shkodrës, Durrësit, Vlorës.

Pavarësisht ngarkesës, trupa gjyqësore vijoi të mbetej e paplotësuar me gjyqtarë. Vetëm në fillim të vitit 2016, falë edhe këmbënguljes së ministrit të atëhershëm të drejtësisë, Z. Ylli Manjani, u mor vendim që trupa gjyqësore e Gjykatës Administrative të Apelit u rritej nga 7 në 13 gjyqtarë. Rritja e trupës gjyqësore së kësaj Gjykate ka qenë edhe një ndër rekomandimet e raportit të INFOCIP për vitin 2015.

Gjykatat administrative të rretheve gjyqësore (shkalla e parë) vijuan të punojnë me stafe të reduktuara, një pjesë e tyre pothuajse me gjysmën e trupës gjyqësore që parashikon ligjieslacioni përkatës. Gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër kanë punuar me nga 2 gjyqtarët, në vend të minimumit 4 gjyqtarësh që duhet të kishin sipas rregullave në fuqi për kohën të cilin ka vlerësuar ky studim. Gjykata Administrative Durrës dhe Ajo Vlorë kanë punuar më së shumti me 3 gjyqtarë.

Infrastruktura e gjykatave administrative vijoi të trashëgojë mangësi të theksuara edhe në vitin 2016. Sistemet kompiuterike të dokumentimit të çështjeve gjyqësore sapo kanë filluar të jenë funksionale. Sistemet e dokumentimit dhe rregjistrimit të të dhenave gjyqësore vijojnë të jënë të bazuara krysisht në letër (paper-based) duke pamundësuar përpunimin e tyre edhe nga vetë gjykatat për efekt të analizave të tyre të brendshme apo raportimeve institucionale. Viti 2016 shënoi mangësi në drejtim të raporteve vjetore të cilat deri para Reformës në Drejtësi kanë qenë një traditë institucionale dhe kërkesë ligjore gjithashtu.

Gjykatat Administrative arritën në 2016-ën, edhe pse jo pa vështirësi, të hapin faqe interneti në të cilën kanë ekspozuar për publikun të dhëna gjyqësore që kanë bëjnë më së shumti me funksionet e tyre (njoftimin, shpalljen etj).

Gjykata e Lartë mban dhe përditëson një databazë të rregullt të çështjeve gjyqësore në faqen e saj të internetit. Megjithatë, për efekt të këtij vlerësimi tematik, të dhënat janë të pa-kryqëzueshme dhe është dashur disponimi i tyre direkt nga sekretaria e gjykatës.

Gjykata e Apelit gjithashtu ka hapur faqen e saj të internetit duke i dhënë një dimension të ri transparencës e publikun përmes mjeteve bashkëkohore të komunikimit onlinë. Po ashtu edhe Gjykatat Administrative të rretheve kanë faqet e tyre të internetit. Meritë e posaçme për këtë hap cilësor ka Gjykata Adminsitrative Tiranë e cila shtyu përpara këtë proces në bashkërendim me Ministrine e Drejtësisë. Për efekt të këtij vlerësimi, të dhënat që përmbajnë faqet zyrtare janë të pa-përdorshme dhe për këtë arsye ka qenë e nevojshme marrja e të dhënave gjyqësore direkt nga sekretaritë e gjykatave.

Mbajtja e të dhënave në letër ka vijuar të krijojë vështirësi për punën e sekretarive të gjykatave, të cilat përballuan volume të shtuara të punës gjatë vitit 2016. Konstatohet se nuk ka një praktikë uniforme në mbajtjen e të dhënave gjyqësore nga sekretaritë e gjykatave. Edhe numratorët hasen në versione të ndryshme nga gjykata në gjykatë. Kjo vështirëson përpunimin e të dhënave për qëllime të vlerësimit të ngarkesës, vonesave, etj. Rezulton se të dhënat për datën e dorëzimit të vendimit si dhe për hedhjen e shortit nuk mbahen në të njëjtin regjistër themelor ku pasqyrohet numri i regjistrimit të çështjes dhedata e vendimit përkatës. Kjo praktikë duhet të rishikohet dhe të unifikohet sa më parë të jetë e mundur.

Gjykatat Administrative kanë përmirësuar treguesit dorëzimit të vendime-

**VENDIME TE DOREZUARA BRENDA 7 DITEVE**



ve brenda afatit 7-ditor me rreth 15 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2014. Në afat u dorëzuan 59% e vendimeve për çështje themeli, krahasuar me me vetëm 46% dorëzime në afat gjatë vitit 2015.

| | Gjykatat | Zbatimi i ligjit |
|---|---|---|
| 1. | Shkodër | 100% |
| 2. | Korçë | 98% |
| 3. | Vlore | 91% |
| 4. | Gjirokaster | 90% |
| 5. | Tirane | 79% |
| 6. | Dures | 17% |

***Në total, niveli i zbatimi të nenit 42 të ligjit 49/2012 nga të 6 gjykatat administrative të shkallës së parë të marra së bashku është 79.16% sa i takon dorëzimit në afat të vendimeve.***

Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit të vendimeve në sekretarinë e gjykatës së Apelit gjatë 2015-ës ishte 9 ditë (rezultat i përgjithësuar). Sa i takon gjykatave administrative të shkallës së parë, kohëzgjatja mesatare e dorëzimit të vendimeve në sekretarinë e gjykatës gjate vitit 2016 ishte mesatarisht 5.83 dite. Treguesit e vlerësuar nga INFOÇIP flasin per një rritje cilësore në këtë drejtim. Rezultatin më të mirë e përfaqëson gjykata administrative e rrethit gjyqësor Shkodër, me rreth 99% të vendimeve të dorëzuar në sekretari brenda afatit 7 ditor që përcakton neni 42 ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndyshuar.* Ajo ndiqet nga GJA e Korçës, Vlorës, Gjirokastës, Tiranës dhe në fund, Durresit.

Gjatë vitit 2016, shqyrtimi gjyqësor administrativ regjistroi sërish vonesa. Sa i takon Apelit Administrativ, nga vlerësimi rezultoi se, gjate 2016-ës, brenda afatit prej 30 ditësh përfunduan rreth 1% e totalit të cështjeve të themelit të analizuara nga ky studim. Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor gjate 2016-ës në këtë gjykatë rezulton të jetë 589 ditë (çështje gjyqësore themeli). Ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* përcakton afatin 30 ditor për shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit, llogaritur nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi (neni 48/2).

Sa i takon gjykatave administrative të shkallës së parë, në ndryshim nga neni 327 i K.Pr.Civile, (*i shfuqizuar)*, që përcaktonte se shqyrtimi duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga regjistrimi në gjykatë, ligji nr. 49/2012 nuk parashikon afate eksplicite. Kjo përbën një mangësi të theksuar në këtë drejtim e cila rekomandohet të rishikohet në kuadër të amendimeve të mundshme që mund të pësojë ligji në të ardhmen.




INFOCIP gjithsesi aplikoi me analogji afatin 30-ditor për të bërë vlerësimin e këhë-zgjatjes së shqyrtimit gjyqësor në 6 gjykatat administrative të shkallës së parë. Ky ështe edhe afati që aplikon KLD, konform përcaktimeve në Vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve".

Pragu 30-ditor, i konsideruar si afati më i arsyeshëm për përmbylljen e shqyrtimit gjyqësor administrativ në kuadër të këtij studimi është kapur mesatarisht në vetëm 10.83 % të çështjeve të analizuara në shkallë vendi, duke përllogaritur të gjitha gykatat administrative të marra së bashku. Gjithsej nga ky Vlerësim Tematik u analizuan 11036 çështje gjyqësore themeli, vendimi për të cilat është dhënë gjatë vitit 2016.

| | Gjykatat | Brenda 30 ditesh |
|---|---|---|
| 1. | Gjirokastër | 42% |
| 2. | Tiranë | 10% |
| 3. | Korçë | 4% |
| 4. | Shkodër | 3% |
| 5. | Durrës | 3% |
| 6. | Vlore | 3% |

Treguesit më të favorshëm sa i takon shqyrtimit në afat sa më të shkurtër të cështjeve gjyqësore administrative e ka GJA Gjirokastër 42 % të cështjeve të themelit të vendimuara brenda 30-ditësh nga momenti i regjistrimit në gjykatë.

Nga vlerësimi tematik rezulton se vonesa mesatare në shqyrtimin gjyqësor administrativ në shkallë të parë për vitin 2016 është rreth 125.5, krahasuar me 135 ditë ne vitin 2015. Ky eshte gjithsesi nje tregues me i mire se ai i vitit 2015. Me fjalë të tjera, mund të thuhet se gjatë vitit 2016 shqiptarët priten mesatarisht 125. ditë që cështja e tyre të shqyrtohej nga gjykatat administrative të shkallës së parë.

**RENDITJA E GJYKATAVE SIPAS VONESAVE NE SHQYRTIM**




**RENDITJA E GJYKATAVE SIPAS VONESAVE NE DOREZIM**



# METODOLOGJIA

Metodologjia e hartuar nga INFOÇIP konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave mbi datat e dorëzimit në sekretarinë gjyqësore të vendimeve përfundimtare (dosjes gjyqësore pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor) dhe më pas vlerësimin e vonesave eventuale duke kontrastuar datën e vendimit me datën e rregjistrimit të çështjes dhe me datën dorëzimit të tij. Një metode e tillë analizon të gjitha vendimet një për një, siç janë të regjistruara në varg indeksues të rregullt në numratorët e çështjeve gjyqësore (rregjistrat themltarë dhe atyre dytësore) që administrohen nga kancelarët apo sekretaritë e gjykatave.

Medoda e INFOÇIP nuk proceson një numër të reduktuar çështjes (30-40) të zgjedhura me kampionim, por të gjitha vendimet gjyqësore të dorëzuar në një kohë të dhënë. Për vitin 2016 janë analizuar një për një të gjitha vendimet për çështje themeli të dhëna nga të gjitha gjykatat administrative të rretheve (6 gjithsej), nga Gjykata e Apelit Administrativ si dhe nga Kolegji Administrative i Gjykatës së Lartë. Për këtë të fundit janë mbledhur dhe grumbulluar të gjitha vendimet e dhëna edhe gjatë vitit 2015.

Intervali minimal kohor mbi të cilën zbatohet analiza krahasuese është 4 muaj (për gjykatat e rretheve gjyqësore), kurse më i larti është një vit i plotë kalendarik (vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të GJL). Parimi metodologjik deri vitin e kaluar ka qene: "sa më i madh numri i vendimeve që nxjerr një gjykatë në një njësi të dhënë kohe, aq më e vogël fasha kohore që përzgjidhet për analizim krahasues". Në vlerësimin e vitit 2017, të gjitha gjykatat do të krahasohen për treguesit e një viti të plotë kalendarik. Ky standart i ri analizues që do të adoptohet nga INFOÇIP për t'i ardhur në ndihmë publikut të interesuar si dhe organeve të reja në sistemin e drejtësisë.

Për të realizuar këtë vlerësim tematik, që në vitin 2014 u bë identifikimi i saktë i dispozitave në korpusin e brendshëm ligjor (kode dhe ligje) të cilat përcaktojnë afatet e arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Legjitimiteti i matjeve dhe vlerësimeve në kuadër të këtij monitorimi buron vetëm nga ligji material dhe/ose procedural. Po ashtu, monitorimi i pilotua në dy gjykata dhe konkretisht ne GJA te Apelit dhe GJA të Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo fazë ndihmoi shumë në konsolidimin e metodës dhe në kalibrimin e gjetjeve. Pjesa më e madhe e punës gjithsesi në këët ndërhyrje të parë pilot shkoi për dizenimin e një sistemi efikas të përpunimit të dhënave. Po ashtu në këtë fazë u përpunuan edhe indikatorët kryesorë matës ose treguesit.

Treguesi SHDA (*Shqyrtimi i Dosjes Administrative*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekpertët e INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. Ai pasqyrohet në pikë përqindje. SHDA përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve te vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari. Në këtë rast ai indeksohet si "**SHDA vertikal**", për ta dalluar atë nga "**SHDA horizontal**", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Treguesi DAV (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. DAV pasqyrohet në pikë përqindje. Ai është rezultat i diferencës midis vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari.

DAV përdoret për të matur progresin vit pas viti, në kushtet kur krijohet një bazë fillestare me të dhëna të krahasueshme (baseline). Në këtë rast ai indeksohet si "DAV vertikal", për ta dalluar atë nga "DAV horizontal", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshe brenda të njëjtit vit, (siç në rastin e krahasimit të gjykatave administrative të shkallës së parë). DAV është një indikator absolut. Ai nuk relativizion apo ponderon rezultatin bazuar në ngarkesën e gjyqtarëve, vështirësinë e çështjeve, apo shkaqe të tjera subjektive.

Pjesë e rëndësishme e këtij studimi është edhe krahasimi i treguesve mes gjykatave të të njëjtit lloj. Ky lloj vlerësimi synon të ofrojë një pamje më të plotë për kuptuar më mirë dinamikat që favorizojnë (ose jo) shqyrtimin e çështjeve gjyqësore (themeli) brenda një kohë të arsyeshme si dhe

dorëzimin në afat të vendimeve. Në një rast të tillë, treguesit SHDA dhe DAV aplikohen për një vlerësim të tipit horizontal dhe jo vertikal, sikurse është ai që indikon progresin nga viti në viti në të njëjtën gjykatë.

Për të aplikuar analizën SHDA/DAV horizontal, nuk ka nevojë të fiksohet një *baseline* i diferencuar kohor; mjafton që të dhënat të jenë të mbledhura brenda të njëjtës periudhë kohorë për të siguruara bazë krahasimore të njëjtë. Në thelb, analiza synon të rendisë bazuar në vlerat e treguesve gjykatat e të njëjtit lloj të marra nën shqyrtin. Po ashtu kjo analizë ofron mundësi për të bërë përgjithësime në bllok.

Ndërkohë, për të aplikuar analizën SHDA/DAV vertikal, është e nevojshme të fiksohet një *baseline* i bashkë-matshmë kohor. Kjo do të thotë se të dhënat që krahasohen nga viti në viti duhet të jenë të mbledhura brenda të njëjtës periudhë kohorë për të siguruara bazë krahasimore të njëjtë. Kjo analiza synon të indikojë progresin/regresin apo stanjacionin midis dy viteve të ndryshme.

Në Vlerësimin Tematik 2016, SHDA dhe DAV vertikal limitohet në krahasimin e treguesve të mbledhur gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, respektivisht për vitet 2015 dhe 2016. Objekt i kësaj analize me bazë krahasueshmërie 4-mujore janë vetëm gjykatat administrativetë rretheve gjyqësore.

Për gjykatën e Apelit Administrativ, SHDA dhe DAV vertikal përmbledh një periudhe 6 mujore, konkretisht Korrik -Dhjetor 2015 dhe 2016. Për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, SHDA dhe DAV vertikal janë kompletuar tashmë për një periudhë 12 mujore (vjetore) dhe konkretisht 2015 dhe 2016.

Vlerësimi Tematik Kombëtar 2016 ka zgjeruar këtë vit bazën e krahasueshmërisë për të gjithë gjykatat, duke caktuar *baseline* 12-mujor. Treguesi SHDA dhe DAV vertikal për vitin 2017 do të jetë absolut dhe do të shënojë një moment kulmor për cilësinë e këtij lloj vlerësimi.

**U shpallë në Tiranë 15 Dhjetor 2017**

